



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI

Nr. 281/ prot.  
9

Tiranë, më 28.05.2026

V E N D I M

Nr. 136, datë 28.05.2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën me nr.38 Regj., datë 05.02.2026, paraqitur nga Fondacioni Së Bashku kundër Televizionit Top Channel dhe z. Rogert Sterkaj, pjesmarrës në programin Big Brother Albania Vip, në Televizionin Top Channel, me pretendimin për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

K O N S T A T O I:

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisioneri, pala ankuese parashtron se, më 3 shkurt 2026, gjatë programit Big Brother Albania Vip, të transmetuar në Top Channel kundër gazetarit Stenaldo Mehilli, u përdor gjuhë urrejtje nga një pjesmarrës tjetër në program, z. Rogert Sterkaj. Një gjuhë e tillë është e rrezikshme për dinjitetin dhe të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara, sepse duke marrë parasysh audiencën e gjerë të programit, ajo përforcon stereotipet dhe stigmën ekzistuese ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe ndikon në të gjithë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara duke dërguar mesazhin se jeta e personave me aftësi të kufizuara është më pak e denjë për t’u jetuar sesa e atyre pa aftësi të kufizuara.

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi Komisioneri.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 281/1 prot., datë 18.02.2026, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa.
2. Në vijim të kërkesës së mësipërme, Komisioneri ka administruar parashtrimet e Televizionit Top Channel, sipas shkresës nr.105/1 prot, datë 03.03.2026.
3. Me shkresën nr.281/3 prot., datë 17.03.2026, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë të përsëritur për informacion z. Rogert Sterkaj, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, për të depozituar parashtrimet e tij në lidhje me ankesën.

Në vijim, me shkresën nr.105/3 prot., datë 19.03.2026, Top Channel, ka kthyer përgjigje duke informuar se, z.Rogert Sterkaj është konkurrent në programin Big Brother Vip Albania 5, ndaj njoftimi i tij për këtë çështje është i pamundur objektivist për momentin, pasi, së pari, rregullat ndërkombëtare të programit dhe kontratat e nënshkruara prej tij për pjesëmarrjen në këtë program nuk e lejojnë informacionin nga jashtë dhe, së dyti, marrja dijani për një çështje të tillë nga ana e tij do të sillte në mënyrë të pashmangshme shqetësime në gjendjen shpirtërore dhe psikologjike dhe rrezikon daljen e konkurrentit nga programi. Top Channel kërkoi marrjen e parashtrimeve personale të z.Sterkaj menjëherë pas daljes së tij nga programi.

4. Në nenin 92, të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, parashikohet:

*“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.*

*2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.*

*3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit”*

Bazuar në sa më sipër, në kushtet kur z. Rogert Sterkaj, subjekt në këtë procedurë administrative, nuk rezulton të ketë marrë dijeni në lidhje me njoftimet e realizuara nga Komisioneri, si dhe në kushtet kur nuk ka ndonjë ndalim ligjor që e pengon zgjatjen e afatit të procedurës, Komisioneri vendosi të zgjasë afatet proceduriale për shqyrtimin e ankesës me nr. 38 regj, datë 05.02.2026, për 90 ditë të tjera.

**PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 92, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**V E N D O S I :**

1. Zgjatjen e afateve proceduriale për shqyrtimin e ankesës me nr. 38 Regj., datë 05.02.2026, me jo më shumë se 90 ditë të tjera, nga data e marrjes dijeni të këtij vendimi.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**



